

Me 2619 vota, ka fituar Unioni i Studentëve Pro European, për Parlament Studentor dhe Këshillë Studentor të Universitetit të Prishtinës, në zgjedhjet studentore të mbajtura dje.

Sipas rezultateve preliminare, Unioni i Studentëve Pro European ka fituar në zgjedhjet studentore të UP-së, ku dhe mbrëmë ata kanë shpallur fitoren.

Nga 15 organizata kandiduese, vetëm 8 kanë arritur ta kalojnë pragun, gjersa USPE ka dalë e para për 201 vota para të dytës.

USPE falënderon të gjithë studentët që i kanë përkrahur dhe i uron ata për fitoren e madhe, që kanë qenë gjithmonë pranë dhe kanë qenë gjeneratorë të kësaj fitoreje.

"Në këto zgjedhje fituan studentët, fitoi Universiteti i Prishtinës", tha Mejdi Sadiku, sekretar i përgjithshëm i USPE-së. /Telegrafi/